

**20192614038**

**L I G J**

**PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT TE BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM – BANKA BOTËRORE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR LIDHJEN E RRUGËVE LOKALE**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore në shumë prej 70.000.000 euro, të dedikuar për realizimin e Projektit për lidhjen e rrugëve lokale.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen për hua për financimin e Projektit për lidhjen e rrugëve lokale, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati i pagimit të huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej pesë vitesh.

Shkalla e kamatës është EURIBOR gjashtëmujor i rritur për shtrirje fikse.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjen për hua nga neni 2 paragrafi 1 të këtij ligji, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore provizion të njëhershëm në shumë prej 0,25 % të shumës së huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore provizion në lartësi prej 0,25% të pjesës së patërhequr të huas në nivel vjetor.

Huaja do të paguhet në 20 këste gjysmëvjetore secila në shumë prej 5% të shumës së huas. Huaja do të paguhet më 1 mars dhe 1 shtator çdo vit.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji është Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve i kryer ndaj Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, të dedikuara për Projektin për lidhjen e rrugëve lokale, të financuar me Marrëveshjen për hua nga neni 2 i këtij ligji lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtë të zbritjes së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/mallrave nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, të dedikuara për Projektin për lidhjen e rrugëve lokale, të financuar me Marrëveshjen për hua nga neni 2 i këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe taksat importuese, si dhe nga akciza gjatë importit të automjeteve për udhëtarë dhe vajrave minerale.

Për qarkullimin i cili është kryer ndaj Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, për qëllime të Projektit për lidhjen e rrugëve lokale, të financuar me Marrëveshjen për hua nga neni 2 i këtij ligji, për të cilin i njëjti është detyrës tatimor sipas nenit 32 pika 4 dhe nenit 32-a të Ligjit për tatim mbi vlerën e shtuar, lirohet nga detyrimi që ta llogaritë dhe paguajë tatimin mbi vlerën e shtuar.

Detyrësi tatimor i cili kryen qarkullim për të cilin është liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, detyrimisht përveç emrit (emërtimit) të pranuesit të së mirës ose shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë e shënon edhe emërtimin e projektit dhe emërtimin e Marrëveshjes për hua nga neni 2 të këtij ligji.

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve gjatë importit të të mirave të liruara sipas paragrafit 2 të këtij neni, organit kompetent tatimor detyrimisht i dorëzon kopje të Marrëveshjes për hua nga neni 2 i këtij ligji dhe deklaratë se të mirat/mallrat e importuara janë të dedikuara për realizimin e Projektit për lidhjen e rrugëve lokale, të financuar me Marrëveshjen për hua nga neni 2 i këtij ligji.

#### Neni 7

Malli i cili është liruar nga pagesa e taksave importuese në bazë të nenit 6 paragrafi 2 të këtij ligji, në afat prej tri vitesh nga dita e importit, nuk guxon të tjetërsohet, t'i jepet për shfrytëzim tjetrit, të huazohet ose të përdoret ndryshe për qëllime tjera, e jo për ato për të cilat është liruar nga pagesa e taksave importuese, para se të paguhen taksat importuese. Sendet e tilla nuk guxojnë të jepen peng, të huazohen ose të jepen si sigurim për detyrime tjera.

Nëse poseduesi i së drejtës, para skadimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, mallin i cili ka qenë i liruar nga pagesa e taksave importuese në bazë të nenit 6 paragrafi 2 të këtij ligji, ka për qëllim ta përdorë për qëllime tjera, e jo për ato për të cilat është liruar nga pagimi i taksave importuese, parashtron kërkesë për pagesën e borxhit doganor te organi doganor.

Lartësinë e borxhit doganor nga paragrafi 2 i këtij neni, organi doganor e llogarit në bazë të elementeve për përcaktimin e taksave në fuqi në momentin e parashtrimit të kërkesës për pagimin e borxhit doganor.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, lartësia e borxhit doganor llogaritet në bazë të elementeve për përcaktimin e taksave në momentin e pranimit të deklaratës doganore, në bazë të së cilës malli është liruar nga pagesa e taksave importuese.

#### Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.